

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, Bibliotekën e Universitetit dhe studentë të degëve të ndryshme, organizuan me rastin e Ditës Botërore të Poezisë një aktivitet me temë:

"Rrugëtimi i poezisë: Një histori e ndjenjave dhe fjalëve".

Ky aktivitet kishte për qëllim promovimin e poezisë si një formë arti dhe nxitjen e krijimtarisë letrare te të rinjtë dhe dashamirësit e letërsisë. Gjithashtu, ishte një mundësi e shkëlqyer për të nxitur kulturën letrare dhe për të afruar studentët rreth artit të fjalës.

Gjatë aktivitetit studentët lexuan poezi të ndryshme dhe diskutuan mbi ndryshimet që ka pësuar poezia ndër vite, duke analizuar evolucionin e saj dhe ndikimin në shoqëri.

